



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA
AGJENCIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA)
KËSHILLI DREJTUES

VENDIM

NR. 5, DATË 25.04 2018

Sot, më datë 25.04.2018, në orën 10:00, në selinë e Agjencisë së Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), u mbledh Këshilli Drejtues i ADISA, ku janë të pranishëm:

- Znj. Xaira Shurdha (Kryetare);
- Znj. Aulona Mersini (Anëtare);
- Znj. Delina Nano (Anëtare);
- Znj. Vilma Gjata (Çausholli) (Anëtare).

Nuk janë të pranishëm në mbledhje tre anëtarë të Këshillit Drejtues:

- Znj. Eda Spahiu (Anëtare);
- Znj. Romina Kuko (Anëtare);
- Z. Toni Gogu (Anëtar).

Në mbledhje morën pjesë gjithashtu Drejtori Ekzekutiv i ADISA Znj. Anisa Gjika, Drejtori i Administrimit të Brendshëm Znj. Edlira Cimbi, Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit të Shërbimeve Znj. Jonida Taraj dhe Drejtori i Drejtorisë së Financës dhe Administrimit të Ardhurave Z. Gëzim Kallajxhi.

Këshilli Drejtues u mbledh dhe diskutoi për të vendosur lidhur me pikat e rendit të ditës, me të cilat anëtarët, ishin njohur nëpërmjet njoftimit më datë 19.04.2018.

Pasi diskutoi në lidhje me to, në mbështetje të nenit 17 të Ligjit Nr. 13/2016, datë 18.02.2016 “Për mënyrën e ofritit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Drejtues, në unanimitet,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Planit Ekonomiko-Financiar 2018 për ADISA-n, bashkëngjitur këtij Vendimi;
2. Miratimin e shtrirjes në terren për periudhën 2018-2019, bashkëngjitur këtij Vendimi;



3. Miratimin e kalimit e dy automjeteve të ADISA-s në kapital të Këshillit të Ministrave, bashkëngjitur këtij Vendimi.
4. Ngarkohet Drejtori Ekzekutiv i ADISA-s për ndjekjen e mëtejshme të procedurave në zbatim të tij.

Ky Vendim hartohet në 2 (dy) kopje.

KRYETAR I KËSHILLIT DREJTUES



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA

AGJENCIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA

(ADISA)



PROGRAMI EKONOMIK 2018

MIRATOI
Anisa GJIKAJ
Drejt. Ekzekutiv

JANAR 2018
ADISA



Përmbajtja

I.	Hyrje.....	3
II.	Buxheti i miratuar nga Ministria e Financave.....	3
III.	Detajimi i buxhetit dhe analiza e pritshmërisë së realizimit 01 Janar 2018 – 31 Dhjetor 2018.....	4
	A. Fondi i pagave dhe Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore, i miratuar është 130 000 000 lekë dhe 21 769 000 lekë.	4
	B. Fondi për shpenzime operative, shuma miratuar 20 000 000 lekë.....	4
	C. Fondi për investime 2017 shuma 97 000 000 lekë.....	6
IV.	Detajimi i planit të investimeve me financim te huaj.....	6



I. Hyrje

Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) është person juridik, publik i organizuar në formën e agjencisë autonome e krijuar me Ligjin nr. 13/2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”.

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit 109, datë 30.11. 2017 “Për buxhetin e vitit 2018” dhe mbështetur në VKM nr. 306, datë 05.04.2017 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 654, datë 14.09.2016 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara” po Ju paraqesim për miratim programin ekonomik për vitin 2018, i cili ka si qëllim kryesor njohjen dhe miratimin e destinacionit të përdorimit të fondeve buxhetore dhe jo buxhetore duke dhënë një tablo të qartë të prioritetëve, shpenzimeve të pritshme për vitin 2018.

Ky dokument është hartuar nga Drejtoria e Financës dhe Administrimit të të Ardhurave.

II. Buxheti i miratuar nga Ministria e Financave.

Për vitin 2018 buxheti i miratuar nga Ministria e Financave për Agjencinë e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara është në total 418 769 000 leke, me një rritje prej 13% krahasuar me vitin 2017. Buxheti është i përbërë nga financimi i brendshëm në shumën 268 769 000 lekë, i cili është i ndarë më tej në fond page, sigurime shoqërore dhe shëndetësore, shpenzime operative, investime, dhe 150 000 000 lekë financim i huaj i BB¹, të cilin po e paraqesim në mënyre analitike sipas tabelës më poshtë:

Kodi i Qeverisjes	Ministria e Linjës	Kod Institucioni	Emri i Institucionit	Nr. i miratuar i punonjësve	Kapitulli	Programi	Llogaria Ekonomike	Kodi i Thesarit	Debiti
Financim i brendshëm									
001	87	1087017	ADISA	160	01	01330	6000000	3535	130,000,000
001	87	1087017	ADISA	160	01	01330	6010000	3535	21,769,000
001	87	1087017	ADISA	160	01	01330	6020000	3535	20,000,000

¹ Banka Botërore

001	87	1087017	ADISA	160	01	01330	2319999	3535	97,000,000
SHUMA I									268,769,000
<i>Financim i huaj</i>									
001	87	1087017	ADISA	160	01	01330	2300000	3535	80,500,000
001	87	1087017	ADISA	160	02	01330	2310000	3535	69,500,000
SHUMA II									150,000,000
TOTALI I+II									418,769,000

III. Detajimi i buxhetit dhe analiza e pritshmërisë së realizimit 01 Janar 2018 – 31 Dhjetor 2018

A. Fondi i pagave dhe Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore, i miratuar është 130 000 000 lekë dhe 21 769 000 lekë.

Referuar buxhetit të miratuar, konstatojmë se buxheti i miratuar për vitin 2018 ka pësuar një rritje prej 21%. Drejtoria e Financës dhe Administrimit të të Ardhurave, Sektori i Financës bazuar në realizimin e buxhetit faktik 2017, numrin aktual të punonjësve (138 punonjës), fondin mujor të pagave, ka bërë llogaritjet e fondit të nevojshëm. Realizimi i pritshëm do të jetë në masën 95 000 000 lekë ose 72%. Ky nivel realizimi vjen edhe për faktin e miratimit të një fondi më të madh se kërkesa në fazën e projekt buxhetit afatmesëm 2018-2020, në masën 10% më shumë. Referuar sa parashtruam më sipër por dhe ecures së realizimit të investimeve për vitin 2018, hapjes së Qendrës së Integruar Shkodër, konkludojmë që fondi i pagave është i mjaftueshëm për mbulimin e shpenzimeve për paga dhe për një pjesë në periudhën në vijim do të bëjmë kërkesë pranë Ministrisë së Financave për transferim të një pjese për mallra dhe shërbime.

Për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore paraqitet e njëjta situatë me tepriçë fondi në masën 6 189 000 lekë ose në masën 28%.

B. Fondi për shpenzime operative, shuma miratuar 20 000 000 lekë.

Fondi i miratuar prej 20 000 mijë lekë në vitin 2018 është i njëjtë me vitin 2017. Për detajimin e këtij fondi, në mënyrë që të kishim një detajim sa më gjithëpërfshirës në plotësim të nevojave për mallra dhe shërbime, nga ana e Drejtorisë së Financës dhe Administrimit të të Ardhurave

Adresa: Bulevardi "Zhan d'Ark", ish Hoteli i Oficerave, kati i 6-të Tiranë, Albania

E-mail: informacion@adisa.gov.al

është hartuar dhe dërguar shkresa nr. 1179 prot. datë 12.12.2017 “Kërkesë mbi nevojat buxhetore të drejtorive për detajimin e zërit 602 (Shpenzime operative)” të gjithë drejtorive në mënyrë që të merreshin nevojat për çdo Drejtori dhe brenda buxhetit të miratuar të përfshiheshin të gjitha kërkesat e ardhura për aq sa ishte e mundur. Theksojmë se megjithëse kemi një shtesë të numrit mesatar të punonjësve nga 127 në 139 shpenzimet e miratuara nuk reflektonin këtë rritje. Në fazën e projekt buxhetit u kërkuar 45 000 000 lekë dhe u miratuan 20 000 000 lekë, ose 44% e fondit të kërkuar. Në përfundim të procesit të mbledhjes, analizës mbi domosdoshmërinë, detajimi i sugjeruar është sipas tabelës më poshtë:

në lekë

Nr.	Emërtimi	Fondi
1	Energji elektrike	2,416,194
2	Ujësjiellës kanalizime	150,000
3	Shërbimi telefonik	144,000
4	Shërbim postar	130,000
5	Letër biletarie	16,800
6	Shpenzime udhëtim e dieta	600,000
7	Siguracion mjetesh	133,000
8	Shpenzime mirëmbajtje mjeti	180,000
9	Plan rievimi Shkodra	60,000
10	Larje mjetesh	40,000
11	Mirëmbajtje ashensori	118,000
12	Mirëmbajtje printera	95,000
13	Shërbim interneti	600,000
14	Karburant	425,000
15	Shërbimi i ruajtjes fizike	14,179,940
16	Taksa vendore	150,000
17	Blerje kancelari	171,224
18	Blerje material pastrimi	390,842
	Totali	20,000,000

Adresa: Bulevardi “Zhan d ‘Ark ”, ish Hoteli i Oficerave , kati i 6-të Tiranë, Albania

E-mail: informacion@adisa.gov.al

C. Fondi për investime 2017 shuma 97 000 000 lekë.

Për vitin 2018, kemi një rritje prej 7% ose 5 000 000 lekë. Ky fond është menduar dhe rekomandohet të përdoret sipas listës dhe emërtimeve më poshtë:

Nr.	Emri i Institucionit	Emërtimi projektit	Vlera programuar
01	ADISA	Mbështetje për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike me në qendër qytetarin (TVSH)	26,477,730
02	ADISA	Blerje pajisje TIK	8,883,924
03	ADISA	Blerje shkallë dyshe e lartë.	108,000
04	ADISA	Blerje fshesa me korrent.	96,000
05	ADISA	Blerje pajisje TIK (Detyrimi i vitit 2017)	1,792,260
06	ADISA	Fondi i ngrirë (Qendra e Shërbimeve Publike të Integruara Shkodër dhe jo vetëm).	59,642,086
	TOTALI		97,000,000

Burimi i financimit të këtyre fondeve është Buxheti i Shtetit.

Ju informojmë se fondi i ngrirë nuk është detajuar akoma pasi pritet projekt - preventivi i zbatimit që do të përgatitet nga shoqëria e kontraktuar në vijim.

IV. Detajimi i planit të investimeve me financim te huaj

Këto janë fonde të cilat administrohen, prokurohen nga Njësia e Menaxhimit të Projektit “Ofrimi i Shërbimeve Publike me në qendër Qytetarin” së bashku me stafin e ADISA.

Kodi i Qeverisjes	Kod Institucioni	Emri i Institucionit	Nr. i miratuar i punonjësve	Kapitulli	Programi	Llogaria Ekonomike	Kodi i Thesarit	Debiti
Financim i huaj								
001	1087017	ADISA	160	02	01330	2300000	3535	80,500,000
001	1087017	ADISA	160	02	01330	2310000	3535	69,500,000
SHUMA								130,000,000

Detajimi i tyre:

1. Konsulencë dhe shërbime: 80 500 000 lekë.
2. Mallra dhe punime civile: 69 500 000 lekë.


Përgatiti: Znj. Sanijela Totozani
Specialist, Sektori i Financës


Firma


Përgatiti: Znj. Eni Mirçe
Përgjegjës, Sektori i Financës


Firma

Miratoi: Znj. Edlira CIMBI
Drejtor, Drejtoria e Administrimit të Brendshëm


Firma


Miratoi: Znj. Jonida TARAJ
Drejtor, Drejtoria e Zhvillimit të Shërbimeve


Firma

Miratoi: Z. Gëzim KALLAJXHI
Drejtor, Drejtoria e Financës dhe Administrimit të të Ardhurave


Firma

Miratoi: Z. Erkand KOLA
Drejtor, Drejtoria e Zhvillimit dhe Monitorimit të Standardeve


Firma

Data 25/04/2018
Kjo shkresë hartohet në 2 kopje.

SHTIRIRJE RRJETI ADISA

● Qendra të Integruara me një Ndalesë të Krijuara:
(Kavajë, Krujë, Fier, Gjirokastrër)

● Qendra të Integruara me një Ndalesë të planifikuara:



Bashki / Qark	Ambiente të identifikuara	Komente
Berat	Godina ZVRPP/Dega Thesarit Berat	Është verifikuar godina
Dibër	Ish-Godina Universitetit	Është kontaktuar Bashkia Peshkopi, nuk kemi përgjigje
Durrës		
Elbasan		
Lushnjë		
Korçë		
Lezhë	Zyra Vendore e Regjistrimit Pasurive të Paluajshme.	Një mundësi, në pamundësi të ofrimit të ambienteve të tjera
Shkodër	Konvikti Safet Spahiu, KAT I	Ne faze prokurimi projektimi
Kamëz		
Tiranë	Godina Njesia Administrative Nr. 6 dhe Ambientet e ISSH Kinostudio	Identifikuar si mundësi

SHTRIRJE RRJETI ADISA

1. Shtrirja e Qendrave të Integruara

Hapje e 15 Qendrave deri ne 2021. (4 sot, 2+3+4+2)

Hapja e 2 Qendrave të Integruara për 2018




SHKODËR


TIRANË

kerkohet
suport ne
financim

2. Ofrimi i Shërbimeve permes Posta Shqiptare !!!



1. Pogradec
2. Librazhd
3. Lac
4. Kukës
5. Bulqizë
6. Kuçovë
7. Gramsh
8. Përmet
9. Tepelenë
10. Peqin
11. Pukë
12. Burrel



SHTRIRJE RRJETI ADISA

2018

- ❖ ISC Shkoder + 2 mobile units per qarkun – Shtator 2018
- ❖ ISC Tirane – Dhjetor 2018
- ❖ 3 Njesi Adisa ne Poste –Dhjetor 2018
- ❖ Pilotim i qarkut Fier me kolokim ne Bashkite e qarkut – Dhjetor 2018
- ❖ Projektim paraprak per njesite qe do hapen ne 2019– Dhjetor 2018
- ❖ Perzgjedhja ne baze shtrirje gjeografike dhe numer transaksionesh

2019

- ❖ ISC Lezhe
- ❖ ISC Dures
- ❖ ISC Berat
- ❖ 3 Njesi Adisa ne Poste
- ❖ Mobile units ne 3 qarqe Lezhe/ Dures/ Berat
- ❖ Kolokim ne Bashki Qarku Shkoder vs Gjirokatser

Informacion lidhur me propozimin për kalimin kapital të dy automjeteve nga ADISA te Kryeministria

Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara ka në pronësi të saj 7 (shtatë) automjete, ndër të cilat 2 (dy) automjete tip Skoda Yeti dhe Skoda Rapid janë blerë nga ADISA nëpërmjet procedurave përkatëse të prokurimit dhe 5 (pesë) automjete të tjera tip Toyota Prius të cilat kanë kaluar në pronësi të ADISA-s sipas Urdhrit të Përbashkët ndërmjet Kryeministrit (Nr. 6727 Prot., datë 18.11.2016) dhe ADISA-s (Nr. 1353 Prot., 30.11.2016) dhe procesverbalit Nr. 1353/2, datë 30.11.2016.

Kalimi në pronësi i 5 automjeteve tip Toyota Prius me targë AA 043 PL, AA 044 PL, AA 045 PL, AA 046 PL dhe AA 306 PM nga Kryeministria tek ADISA sipas Urdhrit të Përbashkët dhe Procesverbalit përkatës, u realizua me qëllim mbulimin e nevojave të transportit të Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), në kuadër të zgjerimit territorial dhe hapjes së qendrave të reja sipas planifikimeve të kryera.

Nëpërmjet shkresës nr. 911 prot., datë 21.02.2018 “Kërkesë për kalim kapitali automjetesh”, të Sekretarit të Përgjithshëm të Kryeministrit, për nevoja të institucionit të Kryeministrit, është kërkuar kalimi i kapitalit (pa pagesë) të dy automjeteve nga Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike (ADISA) në Kryeministri.

Propozimi

Duke qenë se numri aktual i automjeteve të cilat ka në pronësi ADISA është përtej nevojave të institucionit për transport, mospërdorimi i automjeteve shkakton një amortizim dhe mirëmbajtja e tyre ka kosto financiare, bazuar edhe në shkresën e sipërcituar të Sekretarit të Përgjithshëm të Kryeministrit, propozojmë kalimin e dy automjeteve në pronësi të ADISA-s tek Kryeministria, konkretisht automjetet:

- Toyota Prius, me numër shasie: JTDKB3FU603534116, me targë AA 044 PL;
- Toyota Prius, me numër shasie: JTRKB3FU903534501, me targë AA 306 PM.

Kuadri Ligjor

Kalimi i kapitalit (pa pagesë) të automjeteve nëpërmjet institucioneve të administratës publike realizohet sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Vendimit nr. 153, datë 3.4.1993, të Këshillit të Ministrave “Për kalimin e objekteve, të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore”, të ndryshuar.

Pika 1 Vendimit nr. 153, datë 3.4.1993, të Këshillit të Ministrave “Për kalimin e objekteve, të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore” përcakton se:

- 1. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, si dhe këshillat e rretheve, bashkive e komunave, në raste të veçanta dhe pasi të kenë marrë pëlqimin e këshillave drejtues të ndërmarrjeve e institucioneve, bëjnë kalimin kapital (pa pagesë) të objekteve e të mjeteve kryesore, me përjashtim të objekteve dhe të mjeteve kryesore të institucioneve dhe ndërmarrjeve të sistemit të kulturës, rinisë e sporteve që nuk janë në vartësi të drejtpërdrejtë të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.*



2. Ky kalim bëhet:

b) Me urdhër të përbashkët të titullarëve të ministrive e institucioneve të tjera qendrore, ndërmjet ndërmarrjeve dhe institucioneve të varësisë.

Në respektim të përcaktimeve ligjore të sipërcituara, kalimi i automjeteve të sipërcituara mund të kryhet në bazë të një Urdhri të Përbashkët ndërmjet Kryeministrit dhe ADISA, pasi të jetë marrë pëlqimi i Këshillit Drejtues.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 17 të Ligjit nr. 13/2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë” dhe pikës 1 të VKM nr. 153, datë 3.4.1993, të Këshillit të Ministrave “Për kalimin e objekteve, të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore”, të ndryshuar, kërkojmë miratimin Tuaj për kryerjen e kalimit të 2 (dy) automjeteve tip Toyota Prius me numër shasie: JTDKB3FU603534116 (AA 044 PL) dhe JTRKB3FU903534501 (AA 306 PM) nga ADISA tek Kryeministria, sipas shkresës nr. 911 prot., datë 21.02.2018.

Në vlerësimin Tuaj,